

**VENDIM**  
**Nr.491, datë 17.7.2006**

**PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT TELEVIZIV VENDOR**  
**“TV VIZION +”**

Në mbështetje të nenit 7, pika 21, dhe të nenit 25 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të “Rregullores mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr.162 të KKRT-së, të vendimit nr.478, datë 29.06.2006 të KKRT-së, të nenit 112 pika 2/a të Kodit të Procedurave Administrative të RSH, si dhe të kërkesës së subjektit të interesuar, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

**VENDOSI:**

1. Në mbarim të afatit të licencimit sipas licencës nr. 038/TVL, të rinovojë për një afat të ri 5-vjeçar në fushën e transmetimeve televizive tokësore analogjike, shoqërinë “Media Vizion” sh.a. për televizionin vendor privat “TV Vizion +”.
2. Kushtet e licencës sipas pikës 1 të këtij vendimi mbeten të pandryshuara.
3. Ky vendim hyn në fuqi në datën 3.1.2006 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Halil Lalaj**